

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK.

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Komisionin e Prokurimit Publik me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar”, për periudhën 01.01.2013 deri 30.06.2014, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 166, datë 15.12.2014

Në mbështetje të nenit 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 846/6, datë 15.12.2014, dërguar z. Gentjan Keri, Titullari i Institucionit në Komisionin e Prokurimit, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtëme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

Komisioni i Prokurimit Publik funksionon në bazë ligjit nr. 9463, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 19/1 “Komisioni i Prokurimit Publik”, 19/2 “Përbërja, zgjedhja dhe mandati i Komisionit të Prokurimit Publik”, 19/3 “Kriteret për t’u zgjedhur anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik”, neni 19/4 “Papajtueshmëritë e funksionit të anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik”, neni 19/5 “Mbarimi i funksionit të anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik”, neni 19/6, “Struktura dhe organika e Komisionit të Prokurimit Publik” dhe neni 19/7, si dhe VKM nr. 184 “Për rregulloren e brendshme të funksionimit të KPP”. Kjo bazë i jep institucionit pozitën e një “gjykate” duke i atribuar funksione të cilat legjislativi ia ka dhënë Gjykatës Administrative. **Për këtë është rekomanduar që::**

Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga natyra tejet sensibil e vendimarrjes dhe problematikës që trajton, për ruajtjen e rregullave të lojës në prokurimet publike por dhe garantimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale, të iniciojë ndryshime në ligjin për prokurimin publik lidhur me rregullimin e veprimtarisë dhe eliminimin e funksioneve të mbivendosura me Gjykatën Administrative, dhe nga ana tjetër saktësimin e procedurave, afate optimale dhe tarifimit të shërbimit që ai ofron, nisur nga problematikat e ndeshura gjatë veprimtarisë së tij.

Deri më 30.06.2015.

B. MASA ORGANIZATIVE.

1. Nga auditimi u konstatuan vonesa në kthimin e garancisë operatorëve ankimues. Kështu rezultuan praktika ku kalimi bëhej brenda 2-3 ditëve, por dhe raste ekstreme kur kthimi bëhej pas 2-3 muajsh apo më shumë. Nga ana tjetër konstatuam procese gjyqësore ku kërkohej kthimi i shumave të garancive nga KPP-ja, ndërkohë që përfituesi është buxheti i shtetit (100%). **Për këtë është rekomanduar që:**

Të merren masa të menjëhershme nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, që kthimi i shumave të depozituara si tarifë nga ana e operatorëve ankimues të bëhet në kohë sa më të shkurtër dhe sipas rendit kronologjik të evidentimit të kërkesës për kthim, në mënyrë që ti pritët rruga praktikave të deritanishme të cilat mund të rezultojnë edhe me kosto institucionale në rast të ankimimeve gjyqësore për këto vonesa.

Në vijimësi.

2. Nga auditimi i dokumentacionit për depozitimin dhe kthimin e depozitave, konstatuam se në 4 raste ishte kapërcyer numri rendor apo, ishte fshirë ankesa dhe regjistruar më pas, në rubrikën e njëjtë. Praktika të tilla krijojnë hapësira për mos zbulimin dhe parandalimin e dobësive apo mashtrimeve eventuale. **Për këtë është rekomanduar që:**

Institucioni i Komisionit të Prokurimit Publik, të marrë masa për eliminimin e rasteve të tilla dhe të sigurohet që në çdo rast të zbatohen rregullat për mbajtjen dhe evidentimin e dokumentacionit sipas rregullave të ligjit “Mbi arkivat”, kjo do të mundësojë evidentimin e saktë të regjistrimit të ankesave dhe përgjigjeve të tyre, transparencë më të lartë të vendimarrjes dhe nga ana tjetër, do të mundësojë monitorimin e procedurave të kthimit të depozitave, në mënyrë të atillë, që të eliminohen gabimet njerëzore dhe të parandalohen raste të mundshme të mashtrimeve, për sa kohë që në institucion nuk ekziston një rregullore për funksionimin e kontrollit të brendshëm për parandalimin e rasteve të mashtrimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht.

3. Nga auditimi për shpenzimet e kryera për *abonimin në shtypin e shkruar* u konstatuan parregullsi, ***në shumën 279,460 lekë***, lidhur me monitorimin e realizimit të këtij shërbimi kështu, në kontratat e lidhura midis palëve, nuk ka asnjë përcaktim dhe asnjë klauzolë që përcakton detyrimet e kontraktorit për mungesat e mundshme për mënyrën e marrjes në dorëzim të shtypit si dhe nuk disponohet ndonjë dokument që vërteton marrjen në dorëzim të shtypit të shkruar dhe që provon se, malli i furnizuar ka mbërritur në institucion në përputhje me kontratën. **Për këtë është rekomanduar që:**

Komisioni i Prokurimit Publik, në të ardhmen, të marrë masat që në kontratat e shërbimeve që kërkojnë monitorim të vazhdueshëm të përcaktojë specifika të qarta, lidhur me grafikun e furnizimit, personin që ndjek dhe dokumenton marrjen e mallit si dhe mënyrën e likuidimit të vlerës së kontratës, me qëllim që likuidimi i vlerës së mallit të bëhet pas mbërritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit nga personat e ngarkuar për këtë qëllim.

Vazhdimisht.

4. Nga auditimi u konstatua se është bërë likuidimi për *bileta avioni* për një komisionere ***në shumën 191,915 lekë***, me justifikimin e ndërprerjes së trajnimit për shkak të nevojës për të plotësuar korumin e nevojshëm në mbledhjet e komisionit, pasi bazuar në Vendimin nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për organizmin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik dhe për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 659, datë 03.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, me mjete elektronike”, Kreut II “Organizimi dhe veprimtaria e KPP”, neni 10 mbajtjet dhe votimi, pika 2, përcaktohet se: “*Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme vetëm nëse në të janë të pranishëm të paktën 3 anëtarë, një prej të cilëve duhet të jetë Kryetari ose zëvendëskryetari*”. Nga ballafaqimi i dokumentacionit të mbledhjeve dhe datave të udhëtimit dhe kryqëzimi i tyre, rezultoi se, këto shpenzime udhëtimi kanë qënë të panevojshme pasi, në mbledhjet e komisionit në këto data, ka ekzistuar kuorimi dhe shpenzimet e mësipërme, kanë rënduar padrejtësisht fondet e institucionit dhe përbëjnë përdorim joefektiv të fondeve buxhetore. **Për këtë është rekomanduar që:**

Komisioni i Prokurimit Publik të marrë masat që praktika të tilla të mos përsëriten më dhe të mos kryhen shpenzime, të cilat nuk justifikojnë qëllimin për të cilët duhet të përdoren dhe që përbëjnë përdorim joefektiv të fondeve buxhetore.

Vazhdimisht.

5. Nga auditimi u konstatua se vetëm për periudhën 01.01.2013 deri më 30.06.2014, institucioni i Komisionit të Prokurimit Publik, ka shpenzuar shumën 164,600 lekë për zërin “Shërbim fotokopje, zëvendësim dramë”, gjithashtu rezulton se me këtë procedurë janë shpenzuar për çdo vit fonde, bile që nga momenti kur është blerë fotokopja (viti 2010). Shpenzime të tilla të cilat janë të dokumentuara por jo gjithmonë të arësyetuara flasin për pakujdesi në administrimin e fondeve të institucionit. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nisur nga niveli i shpenzimeve për mirëmbajtjen e fotokopjes, dhe mungesës së domosdoshmërisë së një niveli të tillë shpenzimi institucioni të kryejë një analizë të kostos/përfitimit për shpenzimin e fotokopjes dhe në rast të një rezultati jo të efektshëm të kërkojë zgjidhje teknike me më pak shpenzime. Gjykojmë se një praktikë e tillë duhet të shoqërojë të gjitha shpenzimet operative institucionale për të rritur efektivitetin e përdorimit të fondeve në dispozicion.

Vazhdimisht.

6. Nga auditimi rezultoi se, për periudhën 01.01.2013 – 30.06.2014, institucioni i Komisionit të Prokurimit Publik, nuk ka patur në inventar automjete dhe gjatë vitit 2013, për plotësimin e nevojave të tij, institucioni ka blerë 800 litra karburant, në vlerën 159,500 lekë. Shpenzimet e karburantit në sasinë e mësipërme, janë ndarë me urdhër të brendshëm nga titullari për çdo shërbim të kryer, duke specifikuar datën e udhëtimit, urdhër shërbimit, qytetin dhe punonjësit përkatës, shoqëruar dhe me fletë daljen nga magazina por, pa plotësuar fletët e udhëtimit sipas lëvizjeve të kryera, të cilët duhet të ishin të nënshkruara dhe nga punonjësit udhëtues. **Për këtë është rekomanduar që:**

Komisioni i Prokurimit Publik të marrë masat e duhura që të monitorohet dhe kontrollohet konsumi i karburantit, duke shoqëruar urdhrat e lëvizjeve dhe me dokumentacion (fletët e udhëtimit) sipas lëvizjeve të kryera dhe të nënshkruara nga punonjësit përkatës udhëtues specifikuar kjo në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”.

Vazhdimisht.

7. Nga auditimi u konstatua mungesa e kontrollit të duhur dhe monitorimit të kontratave, praktikë kjo në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, kështu për blerjet e pajisjeve si kolltuk, karrike, televizor, telefon celular, si dhe për kryerjen e shërbimeve ndaj tyre, nuk evidentohet kërkesa mbi domosdoshmërinë e tyre nga njësitë operationale të institucionit. Në furnizimin me mallra dhe shërbime, nuk ka procesverbale të pranimit të mallit ku të cilësohet se malli është pranuar sipas kërkesës. Konstatuam dy raste që pranimi i mallit ishte bërë jo nga zyrtari pranues dhe se, nuk ishte ngritur me një vendim të Kryetarit të KPP-së, komisioni për pranimin e mallit. **Për këtë është rekomanduar që:**

Institucioni i Komisioni i Prokurimit Publik, të marrë masat e duhura për të rishikuar praktikën e punës, ku proceset nuk janë aplikuar në mënyrë efektive, me qëllim sigurimin e një monitorimi të vazhdueshëm në të ardhmen, të kërkesave për mallra e shërbime.

Vazhdimisht.

8. Nga auditimi u konstatua se Zyra e Financës, deri më 01.07.2013, ka pasur në organikë një punonjës specialistë finance/buxheti, që ka kryer njëkohësisht të gjitha detyrat e mbajtjes dhe organizimit të kontabilitetit të njësisë ekonomike, duke u ngarkuar gjithashtu edhe me detyrën e magazinierit. Mbivendosja e përgjegjësisë materiale me atë financiare bie ndesh me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. **Për këtë është rekomanduar që:**

Institucioni i Komisionit të Prokurimit Publik, të rishpërndajë detyrat dhe përgjegjësitë në mënyrë që të eliminohet risku operacional në sektorin e financës dhe të zbatojë me korrektesë kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 15, në mënyrë që të dalin përgjegjësitë e lidhura me dispozitat ligjore në fuqi.

Menjëherë.

9. Nga verifikimi i gjendjes së mallrave dhe materialeve në magazinën e institucionit u konstatuan mallra në vlera të konsiderueshme të marrë nga Avokati i Prokurimeve më datë 03.06.2013, si pajisje elektronike, pajisje kompjuterike, Ipad, aparate telefonie, kondicioner, në vlerën 3,345,663 lekë, të pavëna në funksionim nga institucioni, si dhe pajisje elektronike, celularë, laptop, Ipad, të blerë nga vetë institucioni në vitet 2010, 2011, 2012, për anëtarët (ish-komisionerët e APP). **Për këtë është rekomanduar që:**

Institucioni i Komisionit të Prokurimit Publik, të marrë masat e duhura për të vënë në funksionim sipas kërkesave dhe nevojave të personelit të këtyre pajisjeve, në rast të kundërt, të mundësojë kalimin e tyre në institucione të tjera shtetërore të cilat mund të kenë nevoja materiale, gjithmonë duke zbatuar kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë.

10. Nga auditimi rezultuan pajisje në inventar të pa dorëzuara nga 2 ish-punonjës të larguar nga puna, në vlerën 767,347 lekë. Gjatë auditimit në zbatim të Urdhrit të Titullarit të Institucionit nr. 299, datë 07.10.2014 “Për shpalljen debitorë dhe kthimin e detyrimit nga ana e personave përgjegjës deri më 20.10.2014 në institucion” pajisjet u kthyen në inventar. **Për këtë është rekomanduar që:**

Institucioni i Komisionit të Prokurimit Publik, të vendosë dhe zbatojë rregulla të qarta për dorëzimin e inventarit në përdorim nga punonjësit të cilët shkëpusin marrdhëniet e punës me institucionin dhe në çdo rast të verifikojë dhe të vlerësojë inventarin e dorëzuar në magazinë. Për rastet e dëmtimeve apo difekteve të kërkohej zhdëmtimi nga personi përgjegjës.

Menjëherë.

11. Nga auditimi i shpenzimeve të kryera për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, për ndërprerje të marrëdhënieve të punës pa shkaqe të arsyeshme u konstatua se, me vendimin e Gjykatës së Apelit, nr. 273, datë 20.02.2014, institucioni ka paguar znj. [REDAKTUAR] me detyrë ish-Drejtores e Drejtorisë së Shqyrtimit të Ankesave për shpërblimin në masën e 9.5 paga mujore, gjithsej në shumën 947,862 lekë, si dhe për ekzekutimin e këtij vendimi ka paguar shpenzime përmbarimore në shumën 56,873 lekë. Në total, **shuma 1,004,735 lekë**, përbën përdorim jo efektiv të fondeve buxhetore. **Për këtë është rekomanduar që:**

Komisioni i Prokurimit Publik, të marrë masa që, në të ardhmen të mos marrë veprime për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të punonjësve me institucionin, të pa argumentuar dhe të pa mbështetur në dispozitat ligjore përkatëse në fuqi, të eliminojë rastet e aplikimit të penalteteve për moslikuidimin në kohë të detyrimeve, me qëllim që të eliminohen këto kosto që përbëjnë përdorim joefektiv të buxhetit të institucionit, si dhe të ndiqet me seriozitet mbrojtja e interesave të institucionit në shkallët e gjykimit.

Vazhdimisht.

12. Nga verifikimi i numrit të punonjësve rezultoi se, institucioni për periudhën objekt auditimi, ka respektuar strukturën dhe numrin e punonjësve sipas organikës të miratuar nga Kryeministri dhe se, të gjithë punonjësit janë pjesë e kësaj strukture, por institucioni nuk ka hartuar dhe miratuar detyrat për çdo punonjës në mënyrë analitike, pozicionin, pagën bazë, vjetërsinë dhe shtesat e tjera mbi pagë duke u mjaftuar me listëprezencat dhe urdhërat e brendshëm për emërimet dhe lëvizjet e punonjësve.

Për këtë është rekomanduar që:

Komisioni i Prokurimit Publik të marrë masa që, në çdo rast, pas miratimit të strukturës organike nga Kryeministri, të hartojë dhe të miratojë strukturën organike në mënyrë analitike për çdo punonjës, ku të përcaktohet pozicioni, kategoria përkatëse, paga bazë, vjetërsia dhe shtesat e tjera mbi pagë.

Menjëherë dhe vazhdimisht.

13. Për 6-mujorin e I-rë të vitit 2014, i janë kthyer ankimuesve nga të ardhurat e realizuara 3,607 mijë lekë ndërsa, shuma **12,206 mijë lekë**, për të cilën nuk janë pranuar ankesat, edhe pse kanë përfunduar procedurat e ankimimit, akoma nuk është derdhur në buxhetin e shtetit, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe vendim nr. 56, datë 19.01.2011 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, ndaj procedurave të ankandit publik apo vendimeve për përjashtim nga to, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”. **Për këtë është rekomanduar që:**

Komisioni i Prokurimit Publik të marrë masat e duhura për të derdhur në buxhetin e shtetit shumën **12,206 mijë lekë**, pasi në zbatim të VKM nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe vendim nr. 56, datë 19.01.2011 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, ndaj procedurave të ankandit publik apo vendimeve për përjashtim nga to, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, duhet të ishin derdhur në buxhetin e shtetit pasi, ankesat për këtë shumë nuk janë pranuar dhe se procedurat e ankimimit, kanë përfunduar.

Menjëherë.

14. Njësia në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 4, germa a, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. IV “Zbatimi i MFK”, pika, 4.2.10 “Roli i nëpunësit të njësisë”, germa a), nuk ka hartuar dhe propozuar tek nëpunësi autorizues i njësisë publike planin strategjik i cili përmban objektivat strategjik, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit. **Për këtë është rekomanduar që:**

Në funksion të rritjes së cilësisë të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm, Komisioni i Prokurimit Publik, të marrë masat e duhura për të hartuar dhe propozuar tek nëpunësi autorizues i njësisë publike, planin strategjik duke e azhurnuar atë çdo vit, i cili të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Deri më 28.02.2015.

15. Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 11 “Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë”, pika 2, si dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III, pika 2.5.2 “Menaxhimi i Riskut”,

njësia, nuk ka identifikuar dhe krijuar regjistrin e riskut, vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që venë në rrezik arritjen e objektivave dhe për pasojë drejtuesit, nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë në menaxhimin e riskut. Punonjësit e administratës për vitin 2013, nuk janë trajnuar për menaxhimin e riskut. **Për këtë është rekomanduar që:**

Për të rritur përgjegjshmërinë në menaxhimin e riskut, në drejtim të identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut, institucioni të marrë masa e duhura për të identifikuar dhe krijuar regjistrin e riskut, vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që venë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë.

Deri më 31.01.2015.

16. Nga auditimi rezultoi se, punonjësit e njësisë kanë vepruar dhe kanë realizuar detyrat e tyre, bazuar në strukturën organike dhe rregulloren e brendshme por, në rregullore nuk janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e zv/Kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik, pamvarësisht se zv/Kryetari, nuk është caktuar akoma. Gjithashtu, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, si dhe Kap. III “Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, njësia nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre. **Për këtë është rekomanduar që:**

Komisioni i Prokurimit Publik, të marrë masat e duhura për të bërë ndryshimin e rregullores së brendshme në përshtatje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, si dhe në përputhje me strukturën organike të institucionit me qëllim që, të mos ketë ndryshime midis strukturave të përcaktuara sipas organikës me ato të përcaktuara në rregullore, si dhe të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar rregulla apo, akte administrative të brendshme, të cilat trajtojnë delegimin e kompetencave apo, të detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Deri më 31.01.2015.

17. Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë vitit 2013, në KPP janë organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve, të cilët janë njohur dhe kanë shkëmbyer përvojë për praktikat më të mira në fushën e koncesioneve dhe atë të prokurimit publik por, vetë njësia nuk ka programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 “Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë”, paragrafet “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”.

Menaxherët e njësisë nuk zotërojnë informacion të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit pasi, zbatimi i ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk është respektuar nga të gjithë hallkat e njësisë dhe se, institucioni nuk ka kryer trajnime për kuptimin dhe zbatimin e ligjit. **Për këtë është rekomanduar që:**

Për arritjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, institucioni krahas trajnimeve të kryera, të hartojë dhe programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, duke përfshirë dhe trajnimin për kuptimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualit të dalë në zbatim të tij, në bashkëpunim me Ministrinë e Financës.

Deri më 31.12.2014.

18. Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 16, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III “Procesi i implementimit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.2 “Cikli i MFK-së”, Hapi 5 “Gjurmët e auditimit”, njësia nuk ka hartuar gjurmët e auditimit që ka si qëllim, të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet, etj.

Në rregulloren e brendshme të institucionit, njësia ka përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, shkeljet disiplinore, orarin dhe kohën e punës, etj., por përshkrimet e punës nuk i nënshtrohen verifikimeve apo, rishikimeve periodike të kryera nga eprorët e linjës, si dhe nuk është bërë vlerësimi vjetor i punës për çdo punonjës. **Për këtë është rekomanduar që:**

Me qëllim që të ndihmohet menaxhimi për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, Komisioni i Prokurimit Publik të marrë masat e duhura për të hartuar gjurmët e auditimit, ku të përfshihen proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve me të rëndësishme, si dhe të bëjë vlerësimin vjetor të punës për çdo punonjës.

Deri më 31.12.2014.

19. Në kundërshtim me Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, miratuar me vendimin e KM nr. 184, datë 17.03.2010, i ndryshuar, Kreu III “Procedurat e veprimt”, neni 32 “Arkivimi i dokumentacionit”, pika 1, ku citohet: Komisioni krijon arkivin elektronik për të gjithë dokumentacionin për çdo çështje në përputhje me rregullat mbi arkivat”, njësia nuk ka krijuar arkivën elektronike. **Për këtë është rekomanduar që:**

Institucioni i Komisionit të Prokurimit Publik, të marrë masa e duhura që në ardhmen të parashikojë fonde për investime për sistemi e IT-së, duke bërë të mundur krijimin e një arkive elektronike, si dhe zhvillimin e sistemit në funksion të rritjes së sigurisë së të dhënave për të gjithë format e raportimit që mbulon institucioni, duke përfshirë dhe të dhënat financiare.

Në vijimësi.

20. Nga auditimi rezultoi se, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, pika 1, ku citohet: “... Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitet e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji”, njësia nuk ka dërguar në Kryeministri (në bazë të nenit 19/1 të ligjit për prokurimin publik KPP-ja, është në varësi të Kryeministrit) deklaratën dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm. Po kështu në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kap V “Shtojcat”, Shtojca 2 – Pyetësori i vetë-vlerësimit për komponentet e MFK-së, njësia nuk ka dërguar në Kryeministri pyetësorin e vetëvlerësimit ku citohet se: “I rekomanohet Titullarit të njësisë që të detyrojë drejtuesit e tjerë të strukturave të njësisë të plotësojnë këtë pyetësor për strukturat që kanë në përgjegjësi. Titullari i njësisë do ti përdorë rezultatet për të formuluar një përgjigje të plotë, në lidhje me gjithë subjektin...”. Plotësimi i pyetësorit ka për qëllim të ndihmojë njësinë në identifikimin e atyre aspekteve të kontrollit të brendshëm, ku nevojitet të ndërmerret ndërgjegjësim i mëtijshëm dhe ku duhet të adresohen nevojat për trajnim. **Për këtë është rekomanduar që:**

Institucioni i Komisionit të Prokurimit Publik, të marrë masa e duhura që, në të ardhmen të plotësojë dhe të dërgojë në Kryeministri deklaratën dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe pyetësin e vetëvlërësimit.

Çdo vit.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi, në kundërshtim me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 23 “Periudha e përfitimit”, dhe Udhëzimit nr. 26, datë 16.04.2009 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, janë paguar me raport mjekësor nga institucioni deri 14 ditë dhe nuk është mbajtur kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2013, për 7 punonjës në shumën 12,056 lekë dhe për 6-mujorin e I-rë të vitit 2014, për 4 punonjës në shumën 3,109 mijë lekë, gjithsej në **shumën 15,174 lekë**, si dhe në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, nuk është mbajtur tatimi për raportet mjekësore deri në 14 ditë, për vitin 2013, në shumën 13,447 lekë dhe për 6-mujorin e I-rë të vitit 2014, në shumën 3,536 lekë, gjithsej në **shumën 17,381 lekë**. Për këtë është rekomanduar që::

Komisioni i Prokurimit Publik, të marrë masa për mbajtjen dhe derdhjen e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për 10 punonjës në **shumën 15,174 lekë**, për mos mbajtjen e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për raportet, mjekësore deri në 14 ditë, në kundërshtim me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, neni 23 “Periudha e përfitimit”, dhe Udhëzimit nr. 26, datë 16.04.2009 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, si dhe për mosmbajtjen e tatimit në **shumën 17,381 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”. Gjithashtu, institucioni të llogarisë dhe të derdhë kontributin për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në institucionet përkatëse dhe për pjesën që i takon punëdhënësit.

Menjëherë.

D. TË TJERA.

Nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit u auditua periudha e aktivitetit ekonomiko-financiar, nga 01.01.2013 deri më 30.06.2016 ndërsa, për periudhën tjetër që përfshin vitet 2011-2012, të veprimtarisë ekonomiko-financiare të Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik, nga ana e institucionit tonë do të bëhet e mundur ushtrimi i një auditimi për zbatimin e përputhshmërisë, ligjshmërisë dhe të rregullshmërisë së aktivitetit ekonomiko-financiar në një kohë tjetër sa më të përshtatshme.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT